



MINISTRIA E MBROJTJES E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DIREKTIVA E MBROJTJES 2024

Parathënie

Rendi global aktualisht është duke u përballur me forcën ushtarake për zgjerim teritorësh, si dhe me ndryshime gjeopolitike dhe kërcënime të shtuara të sigurisë, të cilat tashmë shfaqen si në natyrën konvencionale, por edhe në forma hibride duke përfshirë hapësirën kibernetike, atë informative por edhe në sferën ekonomike, sociale dhe politike. Sfidat në fushën e sigurisë shtohen edhe për shkak të mungesës së pjesshme të kontrollit të ndërhyrjeve kibernetike, zhvillimit të teknologjive dhe inteligjencës artificiale.

Interesat strategjike të Shqipërisë janë të lidhura ngushtësisht me përmbushjen e detyrimeve si vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat i Bashkimit Evropian, si dhe me mbrojtjen dhe sigurinë e territorit të përcaktuar në Kushtetutën e RSH-së dhe Traktatin e Atlantikut të Veriut. Sulmet e fundit terroriste dhe aktet e përsëritura destabilizuese në veri të Kosovës, tensionet e shtuara etnike në rajon, si dhe ambicia e ndikimi rus e kinez në vende të zgjedhura të Ballkanit Perëndimor e bëjnë edhe më emergjente nevojën për më tepër burime dhe investime për zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes.

Forcimi i rolit dhe angazhimit ndërkombëtar dhe rajonal në rivendosjen e paqes dhe stabilitetit, rritja e nivelit të sigurisë, si dhe bashkëpunimi me aktorët ndërkombëtarë në menaxhimin e krizave të mundshme, vendos strukturat e sigurisë dhe mbrojtjes në rolin primar në garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm.

Në këtë situatë gjeopolitike, Ministria e Mbrojtjes (MM) dhe Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH) si struktura kryesore për garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes, mbeten faktor vendimtar në arritjen e rezultateve konkrete dhe zbatimin e angazhimeve në kuadër të mbrojtjes kolektive dhe ruajtjen e vlerave dhe interesave kombëtare.

Gjatë vitit 2023, MM dhe strukturat e saj kanë arritur zhvillime të rëndësishme në fushën e modernizimit me rritjen e kapaciteteve të Forcave të Armatosura, përmirësimin e trajtimit financiar për personelin ushtarak dhe atë civil, gjithashtu dhe me kontributin e çmuar të Forcave të Armatosura dhe ekipit të Mbrojtjes Civile, në mbështetje të komunitetit me anë të operacioneve të ndryshme në ndihmë të popullsisë dhe në rastet e fatkeqësive natyrore.

Për vitin 2024, angazhimet dhe prioritetet kryesore të punës të MM dhe të FARSH, do të jenë të lidhura me rritjen e sigurisë kombëtare dhe euroatlantike, zhvillimin e sistemit dhe kapaciteteve të hapësirës ajrore, vijimin e prezencës në misionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së, si dhe kontribut i menjëhershëm në mbështetje të popullsisë civile, në rastet e mundshme të emergjencave civile.

Mbetem besimplotë se institucioni i MM dhe FARSH, do të përmbushin me sukses të gjitha angazhimet, duke kontribuar maksimalisht në arritjen e objektivave të planifikuara, me rezultate konkrete dhe të matshme, që do të kenë impakt jo vetëm në sferën kombëtare por dhe në atë ndërkombëtare.

Niko Peleshi
Ministër i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë

1. Rishikimi i Dokumenteve Strategjik

Në situatën aktuale të përqësimit të ambientit të sigurisë, vendi ynë mbetet një faktor i rëndësishëm dhe i angazhuar plotësisht në funksion të ruajtjes së paqes dhe stabilitetit rajonal dhe global. Si vend anëtar i NATO-s dhe vend kandidat në BE, lind nevoja e Rishikimit, Hartimit dhe Jetësimit të dokumenteve strategjike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, veçanërisht: Strategjia Ushtarake dhe Plan i Afatgjatë i Zhvillimit të Forcave të Armatosura. Nëpërmjet tyre të bëhet i mundur vlerësimi i rreziqeve dhe kërcënimeve; ripërcaktimi i nivelit të ambicies; zhvillimi i kapaciteteve dhe forcave; opsionet e përgjigjes ushtarake; forcimit të instrumentit ushtarak dhe qëndrueshmërisë; si dhe harmonizimit me dinamikën, politikat dhe planet në kontekst NATO dhe BE.

2. Buxheti dhe Investimet e Mbrojtjes

Ti jepet përparësi nevojave të MM dhe Forcave të Armatosura, për përmbushjen e misionit kushtetues dhe detyrimeve ligjore, bazuar në kërkesat e Objektive të Kapaciteteve, Programet e Mbrojtjes, Listën e Integruar të Prioriteteve për vitet 2024-2029, nevojat për përballimin e rreziqeve dhe kërcënimeve që paraqiten në mjedisin e sotëm të sigurisë, si dhe detyrimet ndaj NATO-s, Kapitullit 31 të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së dhe angazhimeve të tjera ndërkombëtare.

Arritja e buxhetit të mbrojtjes në nivel 2% të PBB për vitin 2024 dhe kanalizimi i të paktën 20%-it të këtij buxheti në pajisje kryesore ushtarake, në linjë me Angazhimin e Investimeve të Mbrojtjes të Aleancës, të shërbejë si shtysë jo vetëm për përdorimin e fondeve me transparencë e efikasitet, por edhe si tregues i besueshmërisë politike, reputacionit ndërkombëtar dhe seriozitetit me aleancat tona strategjike.

3. Përkujdesja ndaj Personelit

a. Meritokracia dhe Shanset e Barabarta

Në çdo organizatë dhe sidomos në ato të sigurisë dhe mbrojtjes, kapitali njerëzor përbën aset më të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm. Strukturat përgjegjëse dhe komisionet të garantojnë avancimin e drejtë në arsimim dhe karrierë të personelit, bazuar në meritokraci, nëpërmjet ofrimit të shanseve të barabarta, transparencës dhe shmangies së burokracive. Promovimi i personelit të aftë dhe me integritet është themeli i suksesit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

b. Përmirësimi i Trajtimit

Përmirësimi i vazhdueshëm i trajtimit financiar është i domosdoshëm, si për mbajtjen e ekspertizës dhe eksperiencës, sidomos në kushtet e përballjes me opsionet e një tregu konkurrues jashtë FARSH, ashtu edhe në thithjen e burimeve cilësore për të kontribuar në sektorë të rëndësishëm të MM/FARSH. Si e tillë, edhe në 2024, të vijojë përmirësimi i trajtimit të ushtarakëve aktivë, duke e mbështetur edhe me kuadrin e nevojshëm ligjor.

c. Kujdesi Shëndetësor

Rritja e kujdesit shëndetësor për ushtarakët, ish ushtarakët, familjarët e tyre dhe personelin civil që shërben në FARSH do të vijojë të jetë thelbësore. Të vihet në funksion të plotë laboratorit i analizave dhe klinikës dentare dhe plotësimin me të gjitha pajisjet moderne mjekësore, si dhe trajnimin e Strukturave shëndetësore, duke rritur cilësinë e shërbimeve mjekësore ndaj personelit të

MM/FARSH. Gjithashtu në fokus të jetë ngritja e Sistemit të menaxhimit të të dhënave mjekësore ushtarake, me qëllim rritjen e efikasitetit të shërbimeve mjekësore si dhe shkëmbimin e shpejtë të informacionit mjekësor me vendet aleate e partnere gjatë dislokimit të trupave në misione dhe operacione.

4. Zhvillimi i Kapaciteteve Kritike dhe Qëndrueshmërisë

Krahas zhvillimeve të rëndësishme në fushën e modernizimit dhe rritjes së kapaciteteve të Forcave të Armatosura, fokusi gjatë vitit 2024 dhe në vijim, do të vazhdojë të jetë zhvillimi dhe ngritja e kapaciteteve kritike të mbrojtjes, edhe në frymën e Artikullit 3 të Aleancës për forcimin e Qëndrueshmërisë Kombëtare, konkretisht:

- Ngritja e Kapaciteteve të Mbrojtjes Kundërajrore me Bazë në Tokë dhe kapaciteteve operacionale të sistemeve stacionare dhe të lëvizshme për zbulimin dhe neutralizimin e objekteve fluturues pa pilot (C-UAS) për mbrojtjen e popullsisë, infrastrukturës kritike dhe instalimeve ushtarake të vendit;
- Fuqizimi i kapaciteteve anti-dron, nëpërmjet rritjes së edukimit dhe trajnimit teknik dhe profesional të personelit të përzgjedhur dhe të trajnuar për të qenë të gatshëm në çdo detyrë e mision;
- Implementimi i Kapacitetit të Grup-Batalionit të Lehtë të Këmbësores, përbën objektivin kyç si angazhim ndaj Aleancës. Në kushtet aktuale, përpos arritjeve pozitive të viteve të fundit, mbetet kritike kompletimi i tij me të tërë elementët përbërës të luftimit dhe shërbimeve;
- Konsolidimi i Flotës së Helikopterëve Blackhawk, 2 (dy) prej të cilëve do të merren në dorëzim në janar 2024, konsiderohet thelbësor jo vetëm për angazhime të mundshme në NATO apo BE, por edhe në një perspektivë kombëtare. Kjo flotë duhet të konsolidohet tërësisht për të kryer edhe një gamë misionesh dhe detyrash në mbështetje të autoriteteve civile.
- Zgjerimi i rrjetit të klasifikuar të NATO-s në ambientet e punës së MM, SHPFA, Komanda Kryesore dhe institucione specifike të varësisë, për të rritur efektivitetin e komunikimeve, përfutur nga arkiva e pasur e NATO-s, ruajtur vijimësinë dhe përmbushur detyrimet me cilësi dhe në kohë ndaj NATO-s. Strukturat e ndërlidhjes, IT-së dhe sigurisë, të rrisin përpjekjet për finalizimin e këtij projekti, si dhe të përgatisin udhëzimet dhe procedurat përkatëse, duke u bazuar dhe në praktikat e NATO-s, për lehtësimin e aksesit të përdoruesve ndaj informacionit, dhe duke zbatuar plotësisht rregullat e sigurisë së informacionit;
- Zhvillimi i aftësive të Mbrojtjes Kibernetike për të siguruar qëndrueshmërinë e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe sistemeve kombëtare. Ministria e Mbrojtjes dhe FARSH, të vijnë të përmirësojnë kapacitetet e tyre reaguese, veçanërisht në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara, për të arritur një nivel mbrojtje efikas dhe me kapacitete të plota operacionale;
- Fuqizimi i edukimit profesional mbetet thelbësor, për të siguruar të ardhmen e FARSH me burime njerëzore të mirë edukuar dhe trajnuar, si dhe duke kultivuar karakterin dhe ndjenjën e patriotizmit. Aplikimi i ciklit 4-vjeçar akademik, sipas modelit West Point është fryti i kësaj përpjekje, i cili duhet të vijnë të përmirësohet në kapacitete infrastrukturore, njerëzore, kurrikula dhe teknologji.
- Avancimi Inovativ dhe Teknologjik duhet të marrë përparësi në transformimin dhe modernizimin e sistemeve të mbrojtjes. Kjo qasje duhet të ushqehet duke përdorur mundësitë që ofron Qendra e re e Inovacionit;

- Modernizimi i vazhdueshëm i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore dhe Detare të RSH, duhet të përbëjë një objektiv të rëndësishëm dhe të qëndrueshëm për strukturat e MM dhe FARSH, nëpërmjet përmirësimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve dhe rritjes së bashkëpunimit ndër-institucional me institucionet dhe agjencitë e vendit, me interesa në ajër dhe në det;

- Forcimi i sistemit të përgatitjes dhe Mbrojtjes Civile, si dhe zbatimi i projekteve në kuadër të rehabilitimit dhe parandalimit të fatkeqësive natyrore, të marrë një vëmendje të shtuar me qëllim mirë menaxhimin e situatave të fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga dora e njeriut, si dhe çdo angazhim tjetër në ndihmë të komunitetit. Funksionimi i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të situatave të Emergjencave Civile, si pjesë e Mekanizmit të Mbrojtjes Civile Evropiane, është i domosdoshëm, si dhe përmirësimi i kapaciteteve satelitore, me qëllim rritjen e cilësisë së imazheve për institucionet përfutuese;

- Të vijojë miradministrimi i mallrave të Rezervave dhe Materialeve të Shtetit (RMSH), për përgjigje të menjëhershme në rastet emergjente dhe fatkeqësive natyrore, përmirësimi i kuadrit ligjor duke garantuar mirëfunksionimin e strukturave, rishikimi i strukturës dhe organikës së RMSH, duke marrë në konsideratë personelin e nevojshëm për garantimin e procesit administrativ të institucionit. Të përmirësohet infrastruktura magazinuese e mallrave RMSH, duke rritur sigurinë në rrethim dhe ruajtje të objekteve në të gjitha rajonet e vendit. Riorganizimi dhe konsolidimi i flotës së mjeteve logjistike të ndërhyrjes së RMSH, në rastet e emergjencës dhe gjendjes së jashtëzakonshme.

5. Promovimi dhe Zhvillimi Infrastruktural

Vendi ynë do të fuqizohet më tej si një faktor stabilizues dhe konstruktiv në nivel rajonal, përmes heqjes së barrierave dhe ndërtimit të infrastrukturave të përbashkëta për lëvizjen e lirë dhe të shpejtë të njerëzve, pajisjeve, mallrave dhe kapitaleve. Në këtë kuptim, dhe nën dritën e zhvillimeve dhe implementimit të planeve rajonale të NATO-s, strukturat e MM dhe FARSH, nuk duhet të kursejnë asnjë përpjekje për promovimin e Korridorit VIII, si korridor sigurie që lidh detin Adriatik me Detin e Zi. Përfundimi së shpejti dhe operacionalizimi i Bazës Ajrore të Kuçovës; Ndjekja dhe zhvillimi i projektit ushtarak të Porto Romano-s; Modernizimi i Zonës Trajnuese në Bizë; Mundësimi i infrastrukturës së kapaciteteve depozituese, stoqeve të armatimit, municionit dhe materialeve në mbështetje të aktiviteteve të NATO-s, BE-së, por dhe aleatëve strategjikë si SHBA, mbeten vendimtare për të ardhmen. Rrjedhimisht, stërvitja dhe ndërveprueshmëria, sidomos nëpërmjet serisë së stërvitjeve ushtarake “Defender Europe”, e cila përveç përgatitjes ushtarake përcjell dhe mesazh strategjik, duhet të kenë rritje.

6. Kontribut për Paqe dhe Siguri

Shqipëria do të qëndrojë e angazhuar në misione, operacione dhe iniciativa të NATO-s, BE-së, OKB-së dhe koalicione vullneti. Kjo është një fushë, ku vendi ynë është vlerësuar gjithmonë maksimalisht, e dukshme nga prezenca në rajone të ndryshme të globit, e cila e rendit Shqipërinë si një eksportuese e sigurisë, stabilitetit dhe prosperitetit. Gjithashtu, personeli ynë ushtarak nëpër botë, të vazhdojë të konsolidojë pozicionin dhe imazhin e vendit tonë në arenën ndërkombëtare, si një instrument për të arritur qëllimet politike dhe për të treguar angazhimin dhe kontributin e çmuar të përfaqësimit tonë në dimensionin global.

7. Përmirësimi i produkteve të inteligjencës

Mbështetja e vendimmarrjes me informacion të shpejtë dhe të plotë, mbi kërcënimet dhe rreziqet është një kërkesë e vazhdueshme dhe e domosdoshme, sidomos në mjedisin aktual të përkeqësuar të sigurisë. Rritja e cilësisë së produkteve të inteligjencës të jetë në fokus të strukturave të inteligjencës dhe sigurisë. Kjo të realizohet nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit me institucionet e inteligjencës dhe sigurisë brenda dhe jashtë vendit, modernizimit të kapaciteteve grumbulluese dhe analizuese, duke përfituar dhe nga avantazhet teknologjike, si dhe mundësisë së shfrytëzimit të inteligjencës artificiale.

8. Nye Bashkëpunimi për Siguri dhe Mbrojtje

Implementimi me sukses i një pjese të mirë të objektivave sa më sipër, lidhet ngushtësisht dhe nga bashkëpunimi me aleatët dhe partnerët tanë. Në këtë drejtim, vijimi dhe forcimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes dhe atë ushtarake në mënyrë bilaterale (veçanërisht me Kosovën), aleatët e partnerët strategjikë, si dhe me vendet e rajonit, do të mbetet prioriteti ynë. Viti 2024 do ta kthejë vendin tonë në një pol të rëndësishëm sigurie rajonale dhe të komunikimit strategjik, duke kryesuar iniciativa të rëndësishme si US-A5 Karta e Adriatikut, Balkans Chief of Defense, duke organizuar Ministerialin e Procesit të Mbrojtjes Juglindore (SEDM), si dhe përvjetorin e 15-të të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Fokusi në këtë drejtim të jetë marrja e masave të plota organizative dhe përmbushja e detyrimeve respektive.

Përfundim

Kjo direktivë do të jetë busulla e orientimit të ideve, strategjive dhe risive dhe duhet të zbatohet me sukses me anë të realizimit të prioritetëve, projekteve dhe proceseve gjithëpërfshirëse, si dhe angazhimin e strukturave të MM, SHPPFA dhe institucioneve të varësisë. Monitorimi i Direktivës së Mbrojtjes 2024, do të realizohet me anë të vlerësimeve 6-mujore periodike dhe matjes së indikatorëve të performancës vjetore për aktivitetet e përfshira në objektivat strategjike të dokumentit.